



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:175929  
Datë: 22.08.2023  
Numri i dokumentit: 04604097

**PS.nr.40/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti Special**, kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Kujtim Krasniqi, me bashkëpunëtorin profesional Laurant Avdyli, në çështjen penale kundër të pandehurit E.A, për shkak të veprave penale Kontrabandim i mallrave nga neni 317 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 paragrafi 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.28/17, të datës 17.08.2023, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të datës 18.08.2023, në prezencën e Prokurorit të PSRK-së Burim Çerkini, të pandehurit E.A, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Adem Vokshi, me datë 22.08.2023, mori dhe përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**E.A**, nga babai I., e ëma R., mbiemri i vajzërisë R., i lindur më ..., në fshatin T., komuna S., ku edhe jeton, me numër personal ..., shqiptar, Shtetas i R. së M., deklaron se posedon edhe nënshtetësi të R. së K. por nuk e posedon me vete ID dhe nuk e din numrin personale përmendësh, ka një adresë në fshatin K., Komuna e V..

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

**I.** Gjatë muajit Korrik 2017 e deri me 08 Gusht 2018 në ne bashkëkryerje dhe në vazhdim me të pandehurit F. A., X. I. dhe Z. M. me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm ka kontrabanduar mall nga R. e M. për në R. e K. duke i'u shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave, përfshire këtu edhe produktet akcizore si Duhan dhe Vajra Motorrike, kanë transportuar mallra te kontrabanduar nga fshati T. ne drejtim te V., ku referuar ngarkesës që i është konfiskuar me datën 31.10.2017, vlera e mallit të konfiskuar është .. ndërsa referuar sasisë së konfiskuar në shtëpinë e të pandehurit me date 31.07.2018 nga ana e Policisë, sasia prej 700 boksa cigare te llojit “Pall Mall” me banderola te M. kapin vlerën e mallit .. euro e të cilat janë konfiskuar nga ana e policisë,

- Me këtë ka kryer veprën penale **Kontrabandim i mallrave nga neni 317 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së**

**II.** Me datën 31.10.2017, dhe 31.07.2018, në V., i pandehuri E.A në bashkëkryerje me të pandehurit X.I. dhe Z. M. me qëllim që vetes t'i mundësojnë shmangien nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve që paguhen me rastin e importimit apo

eksportimit të mallrave, me rastin e importimit të mallit, nuk ka bërë deklarin e mallit – Duhan dhe Vajra Motorrike e që pas kontrollit të bërë nga Doganat e Kosovës në kuadër të aksionit “R.”, është evidentuar mall pa mbulesë dokumentacioni në vlerë prej 7334,00 €, dhe me këtë i është shmangur pagesës së taksave doganore në shumë prej 2185.53 € si dhe është evidentuar mall pa mbulesë dokumentacioni dhe atë 700 boksa cigare të llojit Pall Mall dhe me këtë i është shmangur pagesës së taksave doganore dhe akcizës në shumë prej 7870.00 €.

- Me këtë ka kryer veprën penale **Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga nen. 318 paragrafi 1 të KPRK-së,**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 6, 7, 17, 41, 43, 45, 46, 47, 73, 74 të KPRK-së, si dhe neneve 230, 359 dhe 364 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit i:

### CAKTON

- I. Për veprën penale **Kontrabandim i mallrave nga neni 317 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së**, të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **dënimin me burgim prej 6 muajve, konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet në Dënim me Gjobë në shumë prej 3.500.00 € (tre mijë e pesëqind euro).**
- II. Për veprën penale **Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 paragrafi 1 të KPRK-së**, të përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **Dënim me Gjobë në shumë prej 2.500.00 € (dymijë e pesëqind euro).**

Konform nenit 80, par.2, pika 2.4 të KPRK-së, të njëjtin e:

### GJYKON

- **ME DËNIM UNIK ME GJOBË**, në shumë prej **6.000.00 € (gjashtë mijë euro)**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- I pandehuri dënimin e shqiptuar mund të paguajë deri në 4 (katër) këste por jo më gjatë se 1 (një) vit nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.
- Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin unik me gjobë, atëherë të pandehurit dënimin unik me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim, duke e llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim nga 20 € (njëzet euro).
- Obligohet i pandehuri që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe atë; në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) dhe për fondin e viktimave të krimit shumën prej 100€

(njëqind euro), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit me detyrim.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzën PPS.nr.28/17, të datës 17.08.2023, kundër të pandehurit E.A për shkak të veprave penale Kontrabandim i mallrave nga neni 317 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 paragrafi 1 të KPRK-së, ndërsa me datën 09.08.2023 është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë e cila është dorëzuar gjykatës së bashku me aktakuzën.

Me datë 22.08.2023, Kryetari i trupit gjykues pas pranimit të aktakuzës dhe marrëveshjes për praninë të fajësisë ka caktuar dhe ka mbajtur seancë dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi praninë e fajësisë ku në pajtim me dispozitat e nenit 230 paragrafi 14 dhe 241 paragrafi 5 të KPPRK, ka shqyrtuar marrëveshjen mbi praninë e fajësisë ashtu që ka dëgjuar Prokurorin e PSRK-së Burim Çerkini, të pandehurin E.A me mbrojtësit e tij sipas autorizimit av.Adem Vokshi.

**Prokurori i Prokurorisë Speciale Burim Çerkini** gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi praninë e fajësisë ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes për praninë të fajësisë dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta pranojë ashtu siç është lidhura në mes të prokurorisë, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij e të cilën marrëveshje e ka elaboruar.

Me të pandehurin **E.A** prokurori i PSRK, me datë 09.08.2023 ka lidhur marrëveshje për praninë të fajësisë për veprën penale Kontrabandim i mallrave nga neni 317 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 paragrafi 1 të KPRK-së dhe i ka rekomanduar Gjykatës që për veprën penale Kontrabandim i mallrave nga neni 317 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, të ta gjykojë me dënimin me burgim prej 6 muajve, konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me gjobë në shumë prej 3.500.00 € (tre mijë e pesëqind euro), ndërsa për veprën penale Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga nen. 318 par.1 të KPRK-së, ta gjykojë me dënimin me gjobë në shumë prej 2.500.00 € (dymijë e pesëqind euro).

Mbrojtësi i të pandehurit **E.A, av. Adem Vokshi** gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi praninë e fajësisë ka deklaruar se marrëveshja është lidhur me vullnet dhe mbetet edhe sot në tërësi pranë saj, i ka propozuar gjykatës që të aprovoj marrëveshje mbi praninë të fajësisë pasi që janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e së njëjtes. Ndërsa në seancën lidhur me dënimin ka deklaruar se pajtohet me dënimin e rekomanduar nga prokuroria të nënshkruar sipas marrëveshjes.

I pandehuri E.A ka deklaruar se pajtohet me thëniet e mbrojtësit të tij dhe pajtohet me dënimin e rekomanduar nga PSRK.

## 2. Vlerësimi i marrëveshjeve për pranimin e fajësisë

Gjykata pas shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë të paraqitur nga Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr. 28/17, të datës 17.08.2023, e cila ka të bëjë me të pandehurin E.A për shkak veprave penale Kontrabandim i mallrave nga neni 317 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe deklarimet për pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri në pajtim me dispozitat e nenit 230 par. 17 të KPP-së, gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë faktin se i pandehuri ka kryer veprat penale me të cilat ngarkohet me aktakuzë dhe atë duke u bazuar në pranimin e fajësisë nga vetë i pandehuri dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe si dhe në provat tjera të cilat i përmban aktakuza të cilat prova janë të mjaftueshme për të vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë, ku gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 248 par.1 të KPP-së, për pushimin e procedurës përkatësisht hudhjen e aktakuzës, prandaj gjykata ka konstatuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe bazuar në nenin 230 par.20 të KPP-së të njëjtën e ka pranuar dhe ka vendosur në shkresat e lëndës.

## 3. Gjendjet faktike të vërtetuara

Prandaj, gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit formohen të gjitha elementet e veprave penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke gjetur se me të vërtetë i pandehuri ka kryer veprat penale ashtu siç përshkruhen në aktakuzë dhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe për këtë ka vendosur që të pandehurit ta shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata i dëgjoji deklaratat e të gjitha palëve dhe ka pranuar dënimet e propozuar sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ashtu që duke gjykata i ka shqiptuar dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që i pandehuri ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, andaj gjykata vlerëson se me dënimet e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së, dhe se dënimet e tilla të shqiptuar sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë janë në proporcion me veprat e kryera penale dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i pandehuri.

## 4. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPP-së ndërsa lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 36 par 3, pika 3.1, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 08/L-109).

Vendimi për mos lejimin e afatit për ankesë është marrë duke u bazuar në nenin 485, par.2, ku potencon se “*në qoftë se nuk është parashtruar ankesë ose palët kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë*”, e në rastin konkret palët gjeqjesisht PSRK dhe i pandehuri me mbrojtësin e tij, në marrëveshjen për pranimin e fajësisë kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës, gjykata nuk ka lënë afat ankese dhe ky aktgjykim bëhet i plotfuqishëm menjëherë pas pranimi të tij nga ana e palëve.

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi, e në mbështetje të neneve 230, 358, 364 dhe 365 të KPP-së.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

### **Departamenti Special**

PS.nr.40/2023, i datës 22.08.2023

**Bashkëpunëtori Profesional,**  
Laurant Avdyli

**Kryetari i trupit gjykues- Gjyqtari,**  
Kujtim Krasniqi

### **UDHËZIMI JURIDIK:**

Pasi që palët kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës, aktgjykim i plotfuqishëm në momentin e pranimi të tij nga ana e tyre.